Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Mirësevini në seminarin online të organizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës në bashkëpunim me CiviKos

Tema:

Detyrimet tatimore nga OJQ-të

Sami Salihu – Drejtor i Departamentit për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve

17 Mars 2021

Ligjet e aplikueshme për tatimet

Nr.	Emri i Ligjit	Nr. i Ligjit	Nr. i Udhëzimit Administrativ
1	Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat	Nr. 03/L-222 Nr. 04/L-102 Nr. 04/L-223	Nr. 15/2010 Nr. 03/2016 Nr. 02/2020
2	Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - TVSH	Nr. 05/L-037	Nr. 03/2015 Nr. 06/2016
3	Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale - TAP	Nr. 05/L-028	Nr. 01/2016
4	Ligji për Tatim në të Ardhurat e Korporatave - TAK	Nr. 06/L-105	
5	Ligji për Kontributet Pensionale - KP	Nr. 04/L-168 Nr. 04/L-101 Nr. 05/L-116	
6	Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID 19	Nr. 07/L-016	

Normat tatimore

Lloji i tatimit	Qarkullimi	Norma
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSH	Mbi 30,000 euro	8% dhe 18%
Tatimi në të Ardhura të Korporatave - TAK	Nën pragun për tatuarje reale (30,000 euro)	
Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese, etj.		3%
Veprimtaria shërbyese		9%
Tatimi në të Ardhura të Korporatave - TAK	Mbi pragun për tatuarje reale	10%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP	Nën pragun për tatuarje reale (50,000 euro)	
Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese, etj.		3%
Veprimtaria shërbyese		9%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP	Mbi pragun për tatuarje reale	
Të ardhurat Vjetore nga 0 deri 960		0%
Të ardhurat Vjetore nga 960 - 3000		4%
Të ardhurat Vjetore nga 3,000 deri 5,400		8%
Të ardhurat Vjetore nga 5,400 e tutje		10%
Tatimi i mbajtur në burim në Paga (mujor)		
Të ardhurat mujore nga 0 deri 80		0%
Të ardhurat mujore nga 80 - 250		4%
Të ardhurat mujore nga 250 - 450		8%
Të ardhurat mujore nga 450 e tutje		10%
Tatimi në Qira		10%
Tatimi i mbajtur në burim në qira		9%
Tatimi i mbajtur në burim në interes		10%
Tatimi i mbajtur në burim në të drejta pronësore		10%
Tatimi i mbajtur në burim për kategori të veçanta	Varësisht nga statusi i biznesit	1% ose 3%
Tatimi i mbajtur në burim për jo-rezidentët		5% apo METD

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Tatimi në Paga dhe Kontributet Pensionale

Kush janë tatimpagues për TAP?

- Sipas nenit 3 të Ligjit 05/L-028 për TAP, tatimpagues janë: personat fizikë rezident dhe jo rezident, Ndërmarrja personale afariste, Ortakëritë dhe Shoqëritë, të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto.

Objekt i tatimimit

- Objekt i tatimimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave nga jashtë;

- Objekt i tatimimit për tatimpaguesin jo - rezident janë të ardhurat e tatushme ato që e kanë burimin në Kosovë.

Të Ardhurat e Tatueshme

- Të ardhura të tatueshme për një periudhë të tatueshme janë të ardhurat që rezultojnë nga ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuara ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas Ligjit për TAP lidhur me të ardhurat e tilla bruto.

Shkallët e tatimit në TAP

Tatimi në të Ardhura Personale ngarkohet sipas shkallëve në vijim:

Norma tatimore	Të ardhurat mujore	Të ardhurat vjetore
0%	0 deri 80	0 deri 960
4%	80 deri 250	960 deri 3000
8%	250 deri 450	3000 deri 5400
10%	450 e tutje	5400 e tutje

Të Ardhurat Bruto

- Pagat;
- Të ardhurat nga aktivitetet biznesore;
- Dividentat;
- Interesat;
- Qiratë;
- Fitimet nga lojrat e fatit;
- Fitime nga të drejtat e autorit;
- Pensionet;
- Fitimet kapitale;
- Çdo të ardhur tjetër që rritë pasurinë neto të tatimpaguesit.

Të ardhurat që përjashtohen

- Pagat e përfaqësuesve të huaj diplomatik e konsullor dhe personeli i jashtëm i Ambasadave apo Zyrave të Ndërlidhjes së shteteve të huaja në Kosovë;
- Pagat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare që kanë marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik sipas legjislacionit të tillë;
- Pagat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të agjencive donatore, të kontraktorëve të tyre apo të fondacioneve që realizojnë ndihmën humanitare, punën e rindërtimit, administratën civile apo ndihmën teknike në Kosovë;

Të ardhurat që përjashtohen….

- Pagat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendor të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike;
- Pagat e personelit të jashtëm të KFOR-it dhe EULEX-it;
- Kompensimet për dëmtimin ose shkatërrimin e pronës;
- Të ardhurat nga polisat e sigurimit të jetës që paguhen si rezultat i vdekjes së personit të siguruar;
- Kompensimi për trajtimin mjekësor dhe shpenzimet, duke përfshirë edhe hospitalizimin dhe mjekimin, pos rrogave të paguara gjatë periudhës së mungesës nga puna për shkak të sëmundjes ose lëndimit;

Të ardhurat që përjashtohen ….

- Pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori;
- Pagesat e pensioneve dhe asistencat sociale të paguara nga Qeveria e Kosovës;
- Shpenzimet edukativo arsimore që punëdhënësi paguan të punësuarit me kusht që shpenzimet të jenë paguar drejtpërdrejt në institucionin arsimor dhe me kusht që i punësuari të mbetet edhe për 24 muaj në punë te punëdhënësi pas përfundimit të shkollimit;
- Bursat e marra nga një individ, por me kusht që të paguhet drejtpërdrejt në institucionin edukativo arsimor;
- Shpenzimet e trajnimit;

Të ardhurat që përjashtohen….

- Përfitimet për dëmshpërblime të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore;
- Të ardhurat në formë shpërblimi nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport dhe kulturë;
- Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar për ish të dënuarit politik si dhe kompensimet tjera për kategori të ngjashme;
- Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- Dividenda e pranuar nga personi rezident dhe jo-rezident;
- Paratë e tërhequra nga FKPK apo në Fondet Pensionale për rimëkëmbje ekonomike (10%) - (Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike – COVID 19).

Të ardhurat nga pagat

Në të ardhurat bruto nga pagat, përfshihen:

- Rrogat e paguara në emër të një punëdhënësi për punën të cilën e kryen punonjësi sipas udhëheqjes së drejtorit ose punëdhënësit;
- Bonuset, provizionet, meditjet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës;
- Të ardhurat e fituara nga puna e përkohshme të cilën e kryen punonjësi;
- Të ardhurat nga punësimi i mundshëm, siç është nënshkrimi i një bonusi të rrogës;

Të ardhurat nga pagat....

- Premitë e sigurimit shëndetësor dhe të jetës që një punëdhënës paguan për punonjësin;
- Falja e huas së punonjësit ose e obligimit të punëdhënësit;
- Pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënësi dhe
- Pos nëse përcaktohet ndryshe me Ligjin për TAP, përfitimet në gjësende që një punëdhënës ia jep punonjësit që kalon shumën minimale mbi 65€.

Në të ardhurat bruto nuk përfshihen:

- Kompenzimi i shpenzimeve reale të udhëtimit të biznesit ku përfshihen transporti, ushqimi dhe fjetja për udhëtime zyrtare;
- Transporti – 16 cent për/ km brenda Kosovës, jashtë Kosovës nuk ka limit por vetëm bileta, e gatshme për inspektim;
- Shujta – 15€ brenda dite dhe 25€ nëse nata kalohet në Kosovë, ndërsa për udhëtime jashtë Kosovës, konform Udhezuesit nga Ministria e Financave;
- Fjetja - brenda Kosovës 50€, ndërsa jashtë Kosovës bazuar në Udhezuesin nga Ministria e Financave;

Në të ardhurat bruto nuk përfshihen:

- Dëmshpërblimi për aksidente në punë;
- Kontributet e dhëna nga punëdhënësi në emër të punonjësit;
- Përfitimet në natyrë në formë të shujtave;
- Përfitimet në natyrë në formë të biletave (>1 kilometër);
- Kompensimi për vajtje ardhje në punë (>20 kilometër).

Tatimpaguesit në të Ardhurat nga Pagat

- Të gjithë individët, rezidentë dhe jo-rezidentë, që fitojnë të ardhura nga pagat në Kosovë, do të konsiderohen të punësuar dhe janë të obliguar të paguajnë tatim në të ardhurat personale nga pagat, përveç të punësuarave të huaj në trupat e përcaktuara në Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale në Kosovë.

Hapat që duhet të ndërmerren për aplikimin e Tatimit mbi të Ardhurat nga Pagat

- Kontratat e punëtorëve

  Për secilin punëtor, punëdhënësi duhet t'i ketë kontratat e nënshkruara nga punëdhënësi dhe i punësuari, duhet të jenë të vulosura nga punëdhënësi. Në kontratë përcaktohet pozita e punës, detyrat e punës, data e fillimit, afati i punës, kompenzimi, detyra tjera në bazë të marrëveshjes, etj.

- Kontratë pune për kohë të pacaktuar - caktuar.doc

Regjistrimi i të punësuarit

- Punëdhënësi, përmes deklarimit të listës së pagesës mujore në formatin elektronik të përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, cakton se i punësuari ka përzgjedhur atë si punëdhënës kryesor apo jo;

- Punëdhënësit, të cilët nuk janë të përzgjedhur si punëdhënës kryesor nga i punësuari i tyre, do të trajtohen si punëdhënës sekondar për çështjet tatimore.

Tatimi i mbajtur në burim në paga

- Pagat zakonisht paguhen një herë, dy herë ose edhe më shumë herë në muaj;
- Zbritja pranohet në të njëjtën periudhë tatimore;
- Ndalja e tatimit në burim - lind vetëm kur pagat në të vërtetë janë paguar.

Tatimi në paga

- Punëdhënësit kryesor duhet të llogarisin (për çdo muaj të mbajnë tatimin në burim në paga) dhe të paguajnë tatimin sipas grupimeve të pagave dhe shkallëve tatimore të dhëna në tabelën në vijim:

Shkallët tatimore mujore		Të ardhurat e tatueshme	Përqindja e tatimit	Tatimi mujor
1	2	3 (2-1)	4	5 (3 x 4)
0.00	80.00	80.00	0%	0.00
80.00	250.00	170.00	4%	6.80
250.00	450.00	200.00	8%	16.00
450.00	Mbi	0.00	10%	0.00
			Gjithsej vlera e tatimit	

- Punëdhënësit sekondar duhet ta llogarisin (për çdo muaj të mbajnë tatimin në burim) dhe të paguajnë tatimin, vetëm me shkallën maksimale 10%.

Deklarimi i Tatimit në Paga

- Deklarimi i Tatimit në Paga bëhet vetëm përmes Sistemit Elektronik - EDI, përmes ueb-faqes së ATK-së;
- Pagesa e Tatimit në Paga dhe Pensione duhet të paguhet përmes fletëpagesës së gjeneruar nga Sistemi EDI;
- Pagesa mund të bëhet fizikisht apo përmes E-Banking, në një nga bankat / institucionet e autorizuara në Kosovë;
- Tatimi duhet të paguhet tërësisht në të njëjtën kohë, kur edhe ndalet në burim.

Kontributet Pensionale

- Punëdhënësi (si ai primar ashtu edhe ai sekondar) duhet të kontribuojë 5% në pagën bruto të punëtorit në emër të punëtorit;
- Punëdhënësi duhet të ndalë në burim edhe 5% nga paga bruto e punëtorit, dhe t'i paguajë ato menjëherë në formë të kontributeve pensionale;
- Që të dy, si punëdhënësi ashtu edhe punëtori, mund të ngritin vullnetarisht shumën e kontributit edhe për 10%;
- Kontributi i kombinuar, pra, përqindja e punëtorit dhe punëdhënësit, nuk mund të jetë më e vogël se 10%, por as më e madhe se 30%.

Kontributet Pensionale

- Vetëm kontributi i të punësuarit do të jetë i zbritshëm për qëllime tatimore nga paga e tij / saj;
- Ndërsa kontributi i punëdhënësit do të jetë shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore të punëdhënësit;
- Kontributi Pensional minimal (5% + 5%), duhet të paguhet në FKPK, ndërsa kontributet plotësuese pensionale, mund të paguhen në FKPK apo në ndonjë fond tjetër të licencuar nga BQK.

Shembull - përllogaritja e pagës

I punësuri "X"					
Paga Bruto			450.00 €		
Kontributi nga i punësuari			22.50	5%	
Kontributi nga punëdhënësi			22.50	5%	
Gjithsej kontributi pensional			45.00		
Paga bruto			450.00		
Kontributi nga i punësuari			22.50		
Paga e tatueshme			427.50		
	A	B	C=B-A	D	E=CxD
G1	0.00	80.00	80.00	0%	0.00
G2	80.00	250.00	170.00	4%	6.80
G3	250.00	427.50	177.50	8%	14.20
Tatimi ne paga G1+G2+G3					21.00

I punësuri "Y"					
Paga Bruto			600.00 €		
Kontributi nga i punësuari			30.00	5%	
Kontributi nga punëdhënësi			30.00	5%	
Gjithsej kontributi pensional			60.00		
Paga bruto			600.00		
Kontributi nga i punësuari			30.00		
Paga e tatueshme			570.00		
	A	B	C=B-A	D	E=CxD
G1	0.00	80.00	80.00	0%	0.00
G2	80.00	250.00	170.00	4%	6.80
G3	250.00	450.00	200.00	8%	16.00
G4	450.00	570.00	120.00	10%	12.00
Tatimi ne paga G1+G2+G3+G4					34.80

Libri i pagave mujore

Emri	Mbiemri	Numri Individual i punëtorit	Bruto paga për muaj	Kontributi pensional i të punësuarit	Kontributi pensional i punëdhënësit	Kontributi suplementar i të punësuarit	Kontributi suplementar i punëdhënësit	Punë Primare	Përfshihen Kontributet	Aplikohet Tatimi në Paga
a	b	c	d	e=(d*5%)	f=(d*5%)	g	h	i	j	k

Deklarimi dhe pajisja me Çertifikatë

- Çdo person i cili paguan paga është i obliguar që deri në ditën e 15 të muajit pasues të bëjë deklarimin dhe pagesën e tatimit në paga;
- Çdo person që mban tatimin në burim në paga gjatë një periudhe tatimore, me kërkesë të pranuesit të të ardhurave, është i obliguar të pajis të njëjtin me certifikatën e tatimit të mbajtur në burim, në formën e specifikuar nga ATK.
- Çertifikatë e Kontributit Pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit në Paga.pdf

Shembull:

- Një punëdhënës për muajin Maj i paguan të punësuarit të tij:
  - Rroga ..... 250 €
  - Televizor ..... 250 €
  - Shpenzime personale ..... 60 €
  - Shpenzime biznesore ..... 150 €

- *Çfarë duhet të përfshihet në të ardhura të tatueshme?*

Zgjidhje:

- Një punëdhënës për muajin Maj duhet të përfshijë në të ardhura të tatueshme:
  - Rroga …….. 250 €
  - Televizor …….. 250 € - 65 € = 185 €
  - Shpenzime personale …….. 60 €

Të ardhurat e tatueshme

- Diferenca ndërmjet të ardhurave bruto të fituara gjatë një periudhe tatimore dhe zbritjeve të lejuara me Ligj, na japin të ardhurat e tatueshme, të cilat tatohen sipas shkallëve tatimore në vijim:

E Ardhura Bruto - Zbritjet e Lejuara = Të Ardhurat e Tatueshme

Norma tatimore	Të ardhurat vjetore
0%	0 deri 960
4%	960 deri 3,000
8%	3,000 deri 5,400
10%	5,400 e tutje

Shembull:

- Një i punësuar merr pagë mujore nga punëdhënësi primar prej 400€:
- Kalkulojmë:

400 x 5% (Kontribut Pensional nga i punesuari)=20 €

400 x 5% (Kontribut Pensional nga punedhenesi)=20 €

400 – 20 = 380€ = Ardhura e tatushme

Norma tatimore	Të ardhurat mujore	TMB
0%	0 deri 80	0
4%	80 deri 250	6.80
8%	250 deri 380	10.40
Tatimi i mbajtur në Burim		17.20

Shembull:

- Nëse i punësuari punon edhe te një punëdhënës sekondar dhe merr një pagë prej 200 euro, atëherë kemi këtë përllogaritje:

  200 x 5% (kontributi i të punësuarit) = 10 euro

  200 x 5% (kontributi i punëdhënësit) = 10 euro

  200 - 10 = 190 euro = E ardhura e tatueshme

  190 x 10% = 19.00 euro Tatimi i Mbajtur në Burim

- Ky i punësuar bën Deklaratë Vjetore dhe do të kemi këtë përllogaritje:

Shembull:

- Të ardhura nga punëdhësi primar: 400 x 12 muaj = 4,800€

  Kontribut Pensional …….. 20 x 12 muaj = 240 €

  TMB …… 17.20 x 12 muaj = 206.40 €

- Të ardhura nga punëdhënësi sekondar: 200 x 12 muaj = 2,400€

  Kontribut Pensional ……10 x 12 muaj = 120 €

  TMB …… 19 x 12 muaj = 228 €

Shembull:

- Llogaritja vjetore do të jetë me sa vijon:

  400 x 12 = 4,800 euro (punëdhënësi primar)

  200 x 12 = 2,400 euro (punëdhënësi sekondar)

- Paga bruto 7,200 euro

  TMB 206.40 + 228 = 434.40 euro

  Kontribut Pensional 240+120 = 360 euro

Shembull - deklarimi vjetor:

- 7,200 x 5 % =360 € kontribute pensionale
- 7,200-360= 6,840 € E ardhura e tatueshme

Norma tatimore	Të ardhurat vjetore	TMB
0%	0 deri 960	0.00
4%	960 deri 3,000	81.60
8%	3,000 deri 5,400	192.00
10%	5,400 deri 6,840	144.00
Gjithësejt Tatimi që duhet mbajtur në Burim		417.60
Tatimi i Mbajtur në Burim		434.40
Rimbursim		16.80

Shembull:

- Nëse i punësuari punon vetëm 4 muaj gjatë vitit dhe paga e tij mujore është 300€:

300 X 5% = 15 € (Kontribut Pensional)

300- 15 = 285 € E ardhura e tatueshme

Norma tatimore	Të ardhurat mujore	TMB
0%	0 deri 80	0
4%	80 deri 250	6.80
8%	250 deri 285	2.80
Tatimi i mbajtur në Burim		9.60

Shembull: Llogaritja vjetore:

- Paga bruto vjetore …… 300 x 4 muaj = 1,200 €
- Kontribut Pensional ……. 15 x 4 muaj = 60.00 €
- TMB …… 9.60 x 4 muaj = 38.40 €
- E ardhura e tatueshme 1,200 – 60 (KP) = 1,140 €

Deklarata Vjetore PD.pdf

Norma tatimore	Të ardhurat vjetore	TMB
0%	0 deri 960	0.00
4%	960 deri 1,140	7.20
Gjithësejt Tatimi që duhet mbajtur në Burim		7.20
Tatimi i Mbajtur në Burim		38.40
Rimbursim		**31.20**

Trajtimi i OJQ-ve për Tatim në Qira

Mbajtja e Tatimit në Burim për Qira

- Sipas Ligjit Nr. 06/L-105 për TAK, çdo tatimpagues që i paguan qira personave të cilët janë banorë të Kosovës apo atyre që nuk janë banorë të Kosovës, mban 9% të tatimit në kohën e pagesës apo të kreditimit.

- Për qëllim të pagesës së tatimit të mbajtur në burim, mbajtësit në burim duhet të plotësojnë formularin e mbajtjes së tatimit të burim dhe të pasqyrës së pagesës sikurse përcaktohet nga ATK dhe duhet të dorëzojnë formularin e pagesës në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

- Tatimi i Mbajtur në Burim duhet të paguhet në bankë, apo institucion financiar deri në të 15 ditë të muajit që pason muajin në të cilin pagesa është bërë apo është kredituar.

- Kërkesat për të mbajtur në burim tatimin në qira aplikohen vetëm për “tatimpaguesit” të cilët paguajnë qira.

Shembull 1:

- Një OJQ ka lidhur marrëveshje me një Biznes Individual për marrjen e një objekti me Qira për një periudhë 3 vjeçare, duke filluar nga Janar/2021, pra në këtë rast OJQ është qiramarrësi, i cili do të paguajë nga 1,250€ në muaj.

  – Cilat janë obligimet tatimore, kush duhet të mbajë tatimin në burim për Qira për periudhën Janar/2021?

Përgjigje:

- OJQ obligohet të mbajë tatimin në burim për Qira në shkallën 9%;
- Baza Ligjore: Paragrafi 3 i nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-105 për TAK;
- Çertifikata për mbajtjen e Tatimit në Burim;
- Formulari WR – me të cilin bëhet deklarimi dhe pagesa e tatimit.

- Shembulli 1 - Deklarimi OJQ.pdf

Shembull 2:

- Një OJQ ka lidhur marrëveshje me një Person Juridik për marrjen e një objekti me Qira për një periudhë 3 vjeçare, duke filluar nga Janar/2021, pra në këtë rast Personi Juridik- SHPK është qiradhënësi.
- Marrëveshja në mes të palëve definon që qiradhënësi të paguaj Tatimin në Qira.
- Qiramarrësi do të paguajë nga 1,000€ në muaj.
  - A është konform Ligjit marrëveshja e lidhur në mes qiradhënësit dhe qiramarrësit?

Përgjigje

- Ligji është me fuqi më të lartë se sa Marrëveshjet e bëra në mes palëve;
- OJQ – Qiramarrësi, obligohet të mbajë tatimin në burim për Qira në shkallën 9%;
- Baza Ligjore: Paragrafi 3 i nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-105 për TAK;
- Çertifikata për mbajtjen e Tatimit në Burim;
- Formulari WR – me të cilin bëhet deklarimi dhe pagesa e tatimit;

- Shembulli 2 - Deklarimi OJQ.pdf

Shembull 3:

- Biznesi Sh.P.K. ka marrë objektin me Qira nga një OJQ (Qiradhënës) për një periudhë 1.5 vjet. Sh.P.K, do të paguajë qiradhënësin çdo muaj në vlerën prej 1,600€. Objekti është marrë me qira, që nga muaji Janar/2021.

  - Pasi që Sh.P.K dhe OJQ janë persona juridik, atëherë cili prej tyre obligohet të deklaroj dhe paguaj tatimin në Qira?

Përgjigje:

- Sh.P.K, obligohet të mbajë tatimin në burim për Qira në shkallën 9%;
- Baza Ligjore: Paragrafi 3 i nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-105 për TAK;
- Çertifikata për mbajtjen e Tatimit në Burim;
- Formulari WR – me të cilin bëhet deklarimi dhe pagesa e tatimit;

- Shembulli 3 - Deklarimi OJQ.pdf

Shembull 4:

- OJQ, për muajin Janar/2021, ka marrë me qira objekte të ndryshme nga tre persona, prej të cileve, njëri është Person Fizik dhe do të paguhet 1,200€, personi tjetër është Biznes Individual dhe do të paguhet 1,500€, ndërsa personi tjetër është Person Juridik dhe do të paguhet, po ashtu nga OJQ në vlerën prej 1,700€. Pra, OJQ shfrytëzon objektet me qira nga personat, si në vijim:

Qiramarrës	Qiradhënës	
OJQ	Person Fizik	1,200€
	Biznes Individual	1,500€
	Sh.P.K.	1,700€
Totali:		4,400€

- Cilat janë obligimet tatimore të Qiradhënësve dhe Qiramarrësit?

Përgjigje:

- OJQ obligohet të mbajë tatimin në burim për Qira në shkallën 9%;
- Baza Ligjore: Paragrafi 3 i nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-105 për TAK;
- Çertifikatat e mbajtjes së Tatimit në Burim;
- Formulari WR – me të cilin bëhet deklarimi dhe pagesa;

- Shembulli 4 - Deklarimi OJQ.pdf

Shembull 5:

Kompania “X SHPK” e regjistruar për TVSH, në cilësinë e qiradhënësit dhe “OJQ Y” në cilësinë e qiramarrësit, janë marrë vesh që qiraja mujore për objektin të jetë 1,000€ **NETO** (njëmijë euro e zero cent NETO).

- Cilat duhet të jenë vlerat që ceken në faturë nga kompania “X SHPK” dhe cila është vlera që duhet të paguar “OJQ Y”?

- Sa duhet të jetë Tatimi në qira dhe kush duhet të deklaroj dhe paguaj atë?

Përgjigje:

- Bazuar në paragrafin 3, nenin 31 të Ligjit Nr. 06/L-105 për Tatim në të Ardhura të Korporatave, personi i cili ka për obligim të mbajë tatimin ne burim dhe të paguaj është personi i cili e bënë pagesën e qirasë, pra qiramarrësi dhe ne këtë rast është OJQ “Y”.

- Mbajtja e tatimit ne burim në shkallen prej 9% duhet të aplikohet në shumën pasi të zbritet vlera e TVSH-së, pra për vlerën e TVSH-së nuk duhet të ndalet tatimi në burim.

- Tatimi ne Qira kërkohet të paguhet nga Qiramarrësi. Pra pagesa e tatimit në Qira paguhet nga OJQ “Y”, pasi ta ndal Tatimin në burim.

- Qiradhënësi, “X” SHPK, duhet te aplikojë TVSH-në derisa është person i tatueshëm dhe për këtë ai duhet te deklarojë dhe të paguaj TVSH-në.

Përgjigje (vazhdim):

- Për vlerën Neto te qirasë e cila duhet të jetë 200€ (nëse kontrata ka definuar si të tille që nga qiraja bruto te zbritet TVSH dhe Tatimi në qira), duhet të jenë kalkulimet si në vijim:

$$\frac{1{,}000 \times 9}{100-9} = \frac{9{,}000}{91} = 98.90$$

Pra vlera prej 98.90€ duhet ti shtohet vlerës neto te qirasë dhe te arrihet ne vlerën Bruto (1,000 + 98.960) = 1,098.90€

- Fatura duhet te lëshohet 1,098.90 x 18% TVSH 197.80€
- 1,098.908€ * 18% = 197.80 € do te jete vlera e TVSH-së
- 1,098.90 * 9% = 98.90 € do te jete Tatimi i mbajtur ne burim për Qira
- Fatura duhet te lëshohet nga Qiradhënësi: 1,098.90 * 18% TVSh (197.80 €)= 1,296.70€
- Qiramarrësi do te ndal tatimin ne burim për qira 1,098.90*9% = 98.90€
- Qiramarrësi do ti paguaj qiradhënësit (1,098.90 – 98.90) = 1,000 + 197.80 = 1,197.80€
- Qiradhënësi do te deklaroj dhe paguaj TVSH prej 197.80€
- Qiradhënësit do ti mbetet vlera NETO pas Tatimit = 1,197.80 – 197.80 = 1,000€

- Nga kjo rezulton se nga pagesa totale qe qiradhënësi mori nga qiramarrësi ishte 1,197.80€ dhe pasi te paguat TVSH-ne prej 197.80 €, do te mbetet NETO vlera prej 1,000 €

Trajtimi i OJQ-ve për TVSH

Çka është TVSH-ja?

- Tatim mbi konsumin;
- Paguar nga konsumatori i fundit;
- Baza e TVSH-së;
- Tatim indirekt;
- Mblidhet me anë të vetë – deklarimit;
- Si përcaktohet TVSH për pagesë apo rimbursim?

Objekti i tatuarjes

- Furnizim i mallrave / shërbimeve;
- Të bëra për konsideratë;
- Brenda territorit të Kosovës;
- Nga personi i tatueshëm.

Identifikimi i obliguesve për TVSH Personat e tatueshëm

- Person fizik ose juridik;
- Zhvillon aktivitet ekonomik në Kosovë në mënyrë të *”pavarur”;*
- Qarkullim mbi 30,000 euro brenda vitit kalendarik;
- Deklaruesit vullnetar;
- Personat jorezident;

Regjistrimi në TVSH

- Qarkullimi brenda vitit kalendarik tejkalon 30,000€;
- Deklaruesit vullnetar;
- Aplikacioni për regjistrim në TVSH – Regjistrimi përms Sistemit Elektronik EDI;
- Regjistrimi në mënyrë të detyrueshme;
- Posedon Numër Fiskal / Numër Unik të Regjistrimit;
- Ekspozimi i çertifikatës së TVSH-së;

Ç’regjistrimi nga TVSH

- Aplikimi për ç’regjistrim nga TVSH-ja;
- Shqyrtimi i aplikacionit për ç’regjistrim nga TVSH;
- Ndryshimet e të dhënave në TVSH;

- Kërkesë për çregjistrim nga TVSH.pdf

Trajtimi i OJQ-ve sipas TVSH-së

- OJQ-të nuk konsiderohen të jenë Persona të Tatueshëm për TVSH.
- OJQ-të nuk ngarkojnë dhe nuk deklarojnë TVSH.
- Person i Tatueshëm për TVSH – nëse zhvillojnë aktivitet ekonomik për konsideratë.
- OJQ-të nuk janë të liruara nga TVSH në blerjet vendore.
- OJQ-të nuk janë të liruara nga TVSH në importet e tyre.

Trajtimi i OJQ-ve sipas Ligjit të TVSH-së

- OJQ-të do të lirohen nga pagesa e TVSH-së në donacionet e dhëna për Institucionet e Kosovës, në mbështetje të programeve dhe projekteve humanitare dhe të rindërtimit në Kosovë.

Regjistrimi dhe pajisja me Numër Fiskal

Çdo person që i nënshtrohet ndonjë lloj tatimi të administruar nga ATK, para se të angazhohet në ndonjë veprimtari ekonomike, duhet të pajiset me Numër Fiskal

- Personat Juridik dhe Fizik
- OJQ-të
- Organizatat buxhetore të Institucioneve Qendrore dhe Lokale
- Ortakëritë dhe
- Çdo individ i cili dëshiron ose kërkohet të dorëzojë deklaratë vjetore.



Trajtimi i OJQ-ve sipas Ligjit të TVSH-së

- OJQ-të, të cilat blejnë/importojnë mallra apo shërbime me të ardhurat e donacioneve, nuk duhet t'ju ngarkohet TVSH.

- OJQ-të, të cilave i'u është ngarkuar TVSH në blerjet që janë financuar nga donancionet, kanë të drejtën e Rimbursimit të TVSH-së.

- Vendim-Shpjegues-04-2016-Trajtimi-i-Donacioneve-Per-Qellime-Tatimore.pdf

Kompensimet e TVSH - së

Shembull kur OJQ, ka vetëm të ardhura nga Donacionet

Përshkrimi	Çmimi	TVSH
Vlera e blerjes	20,000€	
TVSH e zbritshme		3,600€
TVSH për t'u rimbursuar apo bartur si tepricë në muajin vijues		3,600€

Kompensimet e TVSH - së

Shembull kur OJQ, ka të ardhura nga Donacionet dhe të ardhura nga Aktivitete komerciale:

Përshkrimi	Çmimi	TVSH
Vlera e shitjes	60,000€	
TVSH e mbledhshme		10,800€
Vlera e blerjes	100,000€	
TVSH e zbritshme		18,000€
Diferenca (TVSH e mbledhshme - TVSH e zbritshme)		(7,200€)
TVSH për t'u rimbursuar apo bartur si tepricë në muajin vijues		7,200€

Kërkesat për Rimbursim të TVSH-së

- Kërkesa e Rimbursimit në periudha tremujore;
- Kërkesa e Rimbursimit në baza mujore, si Rimbursimet për eksportuesit;
- Kërkesa e Rimbursimit në baza mujore, për kontraktorët e Komisionit Evropian (KE).

Kërkesa e Rimbursimit në periudha tremujore

- Në fund të secilit tremujor;
- Shuma e kreditit më e madhe se 3,000 euro;
- Kreditim i vazhdueshëm pas secilës periudhë tatimore;
- Janë dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore;
- Përjashtime - Shuarja e aktivitetit ekonomik;
- Afati i kërkesës për Rimbursim;
- Rimbursimi kërkohet përmes Formularit të TVSH-së.

Shembull: Kërkesa e Rimbursimit në periudha tremujore

Shembull:



Kërkesa e Rimbursimit në baza mujore, si Rimbursimet për eksportuesit

- Në fund të secilit muaj kalendarik;
- Shuma e kreditit më e madhe se 3,000 euro;
- Janë dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore;
- Afati i kërkesës për rimbursim;
- Rimbursimi kërkohet përmes Formularit të TVSH-së.

Kërkesa e Rimbursimit në baza mujore, për kontraktorët e Komisionit Evropian

- Në fund të secilit muaj kalendarik;
- Pa marrë parasyshë shumën e kredititimit;
- Janë dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore;
- Afati i kërkesës për rimbursim;
- Rimbursimi kërkohet përmes Formularit të TVSH-së.
- Shqip_ Vendimi Shpjegues Publik 1 2019 Kontraktoret e Komisionit Evropian 24.01.2019.pdf

Dëshmitë në lidhje me kërkesën e Rimbursimit të TVSH-së

- Të gjitha faturat e blerjeve;
- Të gjitha faturat e shitjeve;
- Të gjithë dokumentacionin doganor;
- Deklaratat tatimore;
- Arësyet e mbi-pagesës ose balancës kreditore;
- Çdo projekt investim.

Libri i Blerjes

Nr.	Fatura		Shitësi			Blerjet dhe Importet e liruara dhe me TVSH jo të zbritshme				Blerjet dhe Importet e tatushme me 18%, si dhe rregullimet e zbritjeve								
	Data	Numri i faturës	Emri i shitësit	Numri Fiskal i shitësit	Numri i TVSH-së së shitësit	Blerjet dhe importet pa TVSH	Blerjet dhe importet investive pa TVSH	Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme	Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	Importet	Importet investive	Blerjet vendore	Blerjet investive vendore	Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar	Fatura e borxhit të keq e lëshuar	Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë	E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me Ngarkesën e Kundërt	Totali i TVSH-së së zbritshme me 18%
Numri i kutisë në Deklaratën e TVSH-së						[31]	[32]	[33]	[34]	[35]	[39]	[43]	[47]	[53]	[57]	[61]	[65]	[K1]

Blerjet dhe Importet e tatushme me 8%, si dhe rregullimet e zbritjeve									Totali i TVSH-së së zbritshme me 18% dhe 8%
Importet	Importet investive	Blerjet vendore	Blerjet investive vendore	Blerjet nga fermerët (aplikimi i normës së sheshtë)	Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar	Fatura e borxhit të keq e lëshuar	Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë	Totali i TVSH-së së zbritshme me 8%	
[37]	[41]	[45]	[49]	[51]	[55]	[59]	[63]	[K2]	[67]

Udhëzues-për-plotësimin-e-LIBRIT-TË-BLERJES.pdf

Libri i Shitjes

Nr.	Fatura		Blerësi			Shitjet e liruara nga TVSH					
	Data	Numri i faturës	Emri i blerësit	Numri Fiskal i blerësit	Numri i TVSH-së së blerësit	Shitjet e liruara pa të drejtë kreditimi	Shitjet e shërbimeve jashtë vendit	Shitjet brenda vendit me ngarkesë të kundërt të TVSH-së	Shitjet tjera të liruara me të drejtë kreditimi	Totali i shitjeve të liruara me të drejtë kreditimi	Eksportet
Numri i kutisë në Deklaratën e TVSH-së						[9]	[10a]	[10b]	[10c]	[10] = [10a]+[10b]+[10c]	[11]

Shitjet e tatueshme me normën 18%						Shitjet e tatueshme me normën 8%					Totali i TVSH-së së llogaritur me 18% dhe 8%
Shitjet e tatueshme	Nota debitore e lëshuar, nota kreditore e pranuar	Fatura e borxhit të keq e pranuar	Rregullimet për të rritur TVSH-në	Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	Totali i TVSH-së së llogaritur me normën 18%	Shitjet e tatueshme	Nota debitore e lëshuar, nota kreditore e pranuar	Fatura e borxhit të keq e pranuar	Rregullimet për të rritur TVSH-në	Totali i TVSH-së së llogaritur me normën 8%	
[12]	[16]	[20]	[24]	[28]	[K1]	[14]	[18]	[22]	[26]	[K2]	[30]

Udhëzues-për-plotësimin-e-LIBRIT-TË-SHITJES.pdf

Deklarimi i TVSH-së

Trajtimi i OJQ-ve për Tatim në të Ardhura të Korporatave

Tatimpaguesit për TAK

Sipas ligjit për TAK, tatimpagues janë personat e mëposhtëm:

- Një korporatë apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në kosovë;
- Një shoqëri tregtare që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;
- Një organizatë e regjistruar si organizatë jo qeveritare sipas legjislacionit që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e ojq-ve, në Kosovës;
- Person jo rezident me njësi të përhershme në Kosovë.

Të ardhurat e liruara

- Të ardhurat e OJQ-ve me Status të Përfitimit Publik (SPP) konsiderohen të ardhura të liruara për TAK;
- Të ardhura të liruara janë vetëm të ardhurat e OJQ-së, të cilat shfrytëzohen për qëllime të përfitimit publik.

Të ardhurat komerciale të OJQ-ve

- OJQ-të të cilat merren me aktivitet komerciale dhe të cilat aktivitete nuk lidhen me SPP i nënshtrohen tatimit në shkallën 10%;
- Për aktivitetet komerciale apo tjetër që nuk është ekskluzivisht i lidhur me qëllimin e saj publik, ATK ka të drejtë të trajtoj tepricën e fitimit që është krijuar prej OJQ-së.

OJQ-të me aktivitetet me SPP dhe komerciale

- Çdo OJQ e cila është e angazhuar në aktivitete të liruara nga tatimi sipas nën-paragrafit 1.1 të nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-105 dhe aktivitete tjera komerciale është e obliguat të mbaj regjistrime të veçanta për aktivitete sipas SPP dhe aktivitete tjera komerciale;
- Barra për vërtetimin e të ardhurave të liruara sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-105 , bie mbi OJQ-në.

Kur OJQ-të trajtohen se krijojnë tepricën e fitimit

- Rasti kur teprica e fitimit të OJQ-së shpërndahet me qëllim të zvogëlimit të fitimit për stafin e saj, si përmes rrogave shumë të larta apo kompensime tjera;
- Aktivitetet e OJQ-së bëhen duke ngarkuar çmime të larta në raport me SPP duke pasur parasysh sasinë dhe kualitetin e mallrave dhe shërbimeve dhe kushtet në të cilat janë siguruar.

Kur OJQ-të trajtohen se krijojnë tepricën e fitimit

- Në rastin e krijimit të të ardhurave nga qiraja duke ngarkuar qira me norma shumë të larta se ato të zakonshme;
- OJQ-të e licencuara si mikrofinanciare për huazimet që bëjnë dhe ngarkojnë interes me norma të cilat janë më të mëdha nga ato që do të paguheshin zakonisht duke pasur parasysh rrezikun, afatin dhe kushtet tjera të kredive.

Shembull nr. 1

Emërtimi	Vlera
Të ardhurat bruto për vitin 2020	152,213.14 €
Pagat bruto	75,712.35 €
Shpenzimet operative	76,500.79 €
Totali i shpenzimeve operative	152,213.14 €

- Në këtë shembull nuk kemi tepricë fitimi.
- OJQ Shembulli 1-2020.pdf
- Fletepagesa OJQ Shembulli 1-2020.pdf

Shembull nr. 2

Emërtimi	Vlera
Të ardhurat bruto për vitin 2020	200,000.00 €
Pagat bruto	80,000.00 €
Shpenzimet operative	90,000.00 €
Totali i shpenzimeve operative	170,000.00 €

- Në këtë shembull kemi tepricë fitimi prej 30,000€, e cila vazhdon të mbetet e hyrë e shtyrë në harmoni me kushtet e kontratës. Në këtë rast të ardhurat bruto për vitin 2020 do të jenë për aq sa janë shpenzimet operative prej 170,000€.
- OJQ Shembulli 2-2020.pdf
- Fletepagesa OJQ Shembulli 2-2020.pdf

Shembulli nr. 3

Një OJQ me SPP, gjatë Vitit 2020, realizoi të ardhura nga Donacionet, si dhe të ardhura nga Aktivitete Komerciale të cilat nuk lidhen me aktivitetin e përfitimit publik, si në vijim:

Transaksionet nga Donacionet	
Emërtimi	Vlera
Të hyra prej donatorëve	70,000.00 €
Pagat Bruto	20,000.00 €
Shpenzimet operative	50,000.00 €
Totali I shpenzimeve operative	70,000.00 €

Transaksionet nga aktivitetet komerciale	
Emërtimi	Vlera
Të hyra nga aktivitetet komerciale	85,000.00 €
Stoku në fillim	30,000.00 €
Blerje gjatë vitit 2020	92,000.00 €
Stoku në fund	80,000.00 €
Kosto e Mallit të Shitur	42,000.00 €
Bruto Fitimi	43,000.00 €
Pagat Bruto	12,000.00 €
Shpenzimet operative	10,000.00 €
Totali I shpenzimeve operative	22,000.00 €
Të ardhura të tatueshme	21,000.00 €

Në këtë shembull kemi tepricë fitimi prej **21,000€.** Teprica e tillë do të konsiderohet si e hyrë komerciale.

OJQ Shembulli 3-2020.pdf

Fletepagesa OJQ Shembulli 3-2020.pdf

Raportimi i blerjeve mbi 500 euro

Raportimi i informatave nga palët e treta

- Të gjithë personat e angazhuar në tregti ose afarizëm të cilët tatohen në bazë të të hyrave reale dhe që bëjnë blerje të mallrave ose shërbimeve nga personi tjetër i tatueshëm në gjithsejtë 500 euro e më shumë në çdo vit të tatueshëm, duhet të paraqesin deklaratë të vërtetë dhe të saktë duke raportuar blerjet e tilla tek ATK-ja;
- Përjashtim nga kjo, personat e tatueshëm të cilët kanë raportuar Librin e Blerjes dhe Librin e Shitjes për komplet vitin (Janar – Dhjetor), nuk kanë obligim të dorëzojnë edhe Raportin e Blerjeve mbi 500 euro.

Kush duhet raportuar për blerjet mbi 500€

- Të gjithë personat e përfshirë në afarizëm të cilët tatohen në bazë të të hyrave reale;
- Qeveria dhe Komunat e Republikës së Kosovës;
- OJQ-të, Institucionet Publike dhe Organizatat e ngjashme;
- Universitetet, Spitalet dhe Institucionet e ngjashme publike apo private, etj.

Afati për dorëzimin e raportit të blerjeve mbi 500 euro është nga 1 janar deri 31 Mars të vitit vijues.

Secili entitet, përveç entitetit qeveritar apo
unal, nga i cili kërkohet të dorëzojë deklarata
informuese dhe nuk dorëzon
atë, do ti nënshtrohet ndëshkimit **125€**.

!

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Çka duhet të përfshijë raporti mbi 500 euro

- Raporti duhet të përfshijë të gjitha mallrat dhe shërbimet e blera nga çdo person;
- Shuma mbi 500 euro nënkupton jo një transaksion të vetëm apo një konsideratë të vetme, por totalin e transaksioneve apo të konsideratave të bëra brenda një periudhe tatimore;
- Blerjet e shërbimeve nga jashtë, ku është aplikuar Ngarkesa e Kundërt;
- Periudhë tatimore nënkupton vitin kalendarik që fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor.

Shembull nr.1

Tatimpaguesi “A” blen nga Tatimpaguesi “B” mallra apo shërbime, si në vijim:

Data	Vlera e blerjes pa TVSH	TVSH	Totali i blerjes
15.01.2020	25.00	4.00	29.00
22.02.2020	80.00	12.80	92.80
16.03.2020	175.00	28.00	203.00
14.04.2020	200.00	32.00	232.00
25.07.2020	560.00	89.60	649.60
17.09.2020	450.00	72.00	522.00
19.11.2020	215.00	34.40	249.40
30.12.2020	95.00	15.20	110.20
Totali	1,800.00	288.00	2,088.00

Në këtë rast derisa blerja totale është mbi 500 euro, keni obligim për të deklaruar në raport.

Shembulli nr.2

Tatimpaguesi “A” blen nga Tatimpaguesi “B” mallra apo shërbime, si në vijim:

Data	Vlera e blerjes pa TVSH	TVSH	Totali i blerjes
15.01.2020	25.00	4.00	29.00
22.02.2020	80.00	12.80	92.80
16.03.2020	15.00	2.40	17.40
14.04.2020	20.00	3.20	23.20
25.07.2020	80.00	12.80	92.80
17.09.2020	45.00	7.20	52.20
19.11.2020	70.00	11.20	81.20
30.12.2020	95.00	15.20	110.20
Totali	430.00	68.80	498.80

Në këtë rast derisa blerja totale është nën 500 euro, nuk keni obligim për të deklaruar në raport.

Cila është forma me të cilën raportohen blerjet mbi 500 euro?

- Forma për raportimin e blerjeve mbi 500 euro shkarkohet nga ueb faqja e ATK-së, www.atk-ks.org;

- Mostra e formës Forma per Raportimin e blerjeve mbi 500 euro.xls.

Afatet e deklarimit dhe pagesa e tatimeve

Nr.	Emërtimi i Formularit	Shkurtesa	Afati i deklarimit	Mënyra e deklarimit
1	Pasqyra tremujore mbi qiranë dhe pasurinë e patrupëzuar	IR	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori	Elektronike (EDI) & Manuale
2	Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për bizneset e mëdha individuale	IL	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori	Elektronike (EDI) & Manuale
3	Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuale	IS	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori	Elektronike (EDI) & Manuale
4	Pasqyra mujore e tatimit në burim në paga dhe kontribute pensionale	WM/CM	Prej 1 deri 15 të çdo muaji	Elektronike (EDI)
5	Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, të drejtat pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit dhe personin jo-rezident	WR	Prej 1 deri 15 të çdo muaji	Elektronike (EDI) & Manuale
6	Pasqyra tremujore e pagesës së tatimit për korporatat e vogla	QS	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori	Elektronike (EDI) & Manuale
7	Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për korporatat e mëdha	QL	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori	Elektronike (EDI) & Manuale
8	Formular i Deklarimit vjetor dhe pagesën për tatimin në të Ardhurat e Korporatave	CD	Prej 1 janar deri 31 mars	Elektronike (EDI) & Manuale
9	Formulari i deklarimit dhe pagesës së TVSH	TV	Prej 1 deri 20 të çdo muaji	Elektronike (EDI)
10	Formular i Deklarimit vjetor dhe pagesën për tatimin mbi të Ardhurat Personale	PD	Prej 1 janar deri 31 mars	Elektronike (EDI) & Manuale
11	Kërkesa për Rimbursim /Kthim	KRR	Prej 1 deri 20 të çdo muaji apo tremujori	Elektronike (EDI)
12	Deklarata e Tatimit në të Ardhurat nga Ortakëria	DO	Prej 1 janar deri 31 mars	Elektronike (EDI) & Manuale
13	Deklarimi i Librit të Blerjes	LB	Prej 1 deri 20 të çdo muaji	Elektronike (EDI)
14	Deklarimi i Librit të Shitjes	LSH	Prej 1 deri 20 të çdo muaji	Elektronike (EDI)
15	Deklarimi i Raportit të blerjeve mbi 500€	RB	Prej 1 janar deri 31 mars	Elektronike (EDI)
16	Deklarimi i Pasqyrave Financiare	PF	Prej 1 janar deri 31 mars	Elektronike (EDI)

Ndëshkimet

- Ndëshkimi për mosdorëzim të deklaratës tatimore 5% në obligimin tatimor, maksimum 5 muaj (25%);

- Ndëshkimi për mospagesën e tatimit 1% në tatimin e papaguar, maksimum 12 muaj (12%), aplikohet pasi të ndërptitet ndëshkimi 5% për mosdorëzim të deklaratës;

- Interesi për mospagesën e tatimit:
  - 1.25% në muaj deri më 31.12.2014;
  - 0.91% nga 01.01.2015 – 31.12.2015;
  - 0.7% nga 01.01.2016 – 31.12.2016;
  - Nga 01.01.2017 e tutje…. 0.65% në muaj.

Funksionimi i Zyrave të Shërbimit të Tatimpaguesve



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Vizitoni ueb faqen e ATK-së

www.atk-ks.org

JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJE!

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo